



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Procesverbal i mbajtur më 10 dhjetor 2024, në mbledhjen e XXX-të (tridhjetë) mandati VII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 10:10.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë; (Naim Çunaku; Arnisa Sylejmani; Haki Rudari; Drita Pajaziti; Sebastina Vokrri; Bashkim Sylja; Mrika Thaçi, kurse mungoi, Qëndrim Softolli) bashkëngjitur lista e nënshkrimeve.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje e pranishëm ishin edhe; *Adelinë Stublla drejtoresh e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS; Saranda Stublla drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ, Lirie Hoti drejtoreshë e Drejtorisë së Bujqësisë Pyllytarisë dhe Zhvillimit Rural-DBPZHR.*

Rendi i ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe duke konstatuar kuorumin, në vazhdim theksoi, thirrja dhe materiali i kësaj mbledhje besoj se ju është dërguar me kohë të gjithëve, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës nëse jo atëherë e hedhim në votim rendin e ditës.

Pas votimit Kryesuesi i Komitetit, konstatoi se Njësëri me 7 vota Për, nga anëtarët/et sa ishin prezent në sallë, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 31 tetor 2024

Pas votimit Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njësëri me 7 vota Për, nga anëtarët/et e Komitetit sa ishin prezent në mbledhje, miratohet pa vërejtje apo plotësim ndryshime procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 31 tetor 2024

2. Propozim vendim për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Podujevës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, kemi një propozim që ka ardhur nga Kryetari i Komunës, ku kemi të bëjmë me një marrëveshje në mes Komunës dhe Bashkësisë Islame që ka qëllim subvencionimin e shpenzimeve të varrimi brenda territorit të Komunës së Podujevës, dhe atë për dy vite pra për vitin 2025 dhe 2026. Kjo ka filluar që të praktikohet shumë më herët dhe tani vetëm jemi duke e vazhduar atë traditën e mëhershme.

z.Naim Çunaku, theksoi, Marrëveshja për shlyerjen e obligimit të varrimit është një praktikë që ka vite që aplikohet në Komunën e Podujevës dhe sigurisht që edhe herën e parë dhe tash do të mbështesim si lehtësim për rastet që ndodhin në Komunën ton. Edhe në vitin e kaluar kur e kemi trajtuar këtë temë kam pas një propozim shtesë që brenda mundësive buxhetore propozoj që në konceptin sa i përket varrimit për rastet në Komunën ton, ku kam propozuar edhe atëherë dhe tani që kësaj t'i shtohet edhe shpenzimet e hapjes së varrit, me kuptimin që e di se Bashkësia Islame e ka marr atë pjesën dhe është arsyetuar që e kemi telash në kuptimin e kapaciteteve gjegjësisht aty duhet të ketë edhe makineri për atë punë, mirëpo mendoj që me funksionalizimin e Ndërmarrjes Publike "Eko Llapi" do të kishte mundësi që shumë lehtë të kooperohet dhe të kompletoj tërësisht këto shpenzime që nënkupton edhe hapjen e varrit.

Arsyetimet e Bashkësisë Islame që kanë qenë që nuk e bëjmë atë sepse nuk i kemi..., për mua nuk janë shumë të qëndrueshme dhe kolegët duhet të mendojnë se si të veprohet tani ngase Bashkësia Islame nuk merret as me teknologji të drurit, por mendoj që do të ishte një lehtësim në mënyrë që të kompletohet, dhe duhet të kërkohet që të kontraktohet Bashkësia Islame, nëse jo me Bashkësinë Islame mundemi me Ndërmarrjen "Eko Llapi" e cila si ndërmarrje komunale do të kishte mundësi që të hynte në funksion në mënyrë që të kontraktohet si procedurë komplete që t'iu dalim në ndihmë qytetarëve.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, në emër të Grup i LVV, e përkrahim këtë propozim vendim që t'i rekomandohet për shqyrtim Kuvendit.

z.Bashkim Syla, theksoi, edhe ne Grupi i PDK-së e përkrahim këtë pikë, mirëpo sa i përket propozimit të z.Naim Çunakut mendoj që është propozim i mirë, mirëpo forma se si të realizohet duhet të diskutohet me Bashkësinë Islame, përndryshe sa i përket Ndërmarrjes "Eko Llapit" unë nuk jam që t'i japim një obligim shtesë, pra duhet të diskutohet me Bashkësinë Islame se si është mënyra më e mirë që të kryhet kjo punë, ndërsa sa i përket që këtë punë ta kryej Ndërmarrja "Eko Llapi" nuk e di sa ka kapacitet që të kryej këtë punë, ndërsa pa e diskutuar me Bashkësinë Islame mendoj se është problem për ta kryer këtë punë, përndryshe si propozim unë jam për dhe e përkrahë sepse e kompletton atë procedurë dhe ja lehtëson familjarëve, por për formën e realizimit duhet të diskutohet.

z.Naim Çunaku, theksoi, marrëveshja është duke u bërë ndërmjet Komunës dhe Bashkësisë Islame dhe jemi të qartë, por Bashkësia Islame qysh ka lidhur marrëveshje me operatorët ekonomik përpunues të drurit mund të lidh marrëveshje edhe me një operator i cili bënë gjermimin e varreve dhe kur e theksova më herët ndërmarrjen "Eko Llapi" nuk mendova që ne duhet të bëjmë sepse nëse hyjmë në marrëdhënie kontraktuale me Ndërmarrjen Eko Llapi dhe atëherë mund t'ia japim edhe dërrasat edhe të tjerat dhe në një formë të përjashtohet Bashkësia Islame, dhe po e njëjta vlen vetëm në ceremoninë e tyre, pra unë nuk dua të hyjë në atë se si e zgjedhin ata por besoj që do të ishte mirë që të kompletojmë atë procedurë, gjegjësisht ceremoninë dhe e kam theksuar më herët e po e theksoj edhe sot, unë nuk mund që të pajtohem me Bashkësinë Islame dhe me praktikën që janë duke ndodhur. Ne të gjithë këtu kemi pasur raste në shoqëri dhe kemi dëgjuar, pra për mua është e pakuptimtë kur Bashkësia Islame në ditën që një familje ka rast vdekje pyetjen e parë që i'a bënë është a i ke shlyer obligimet e anëtarësisë, dhe për mu nuk është në rregull që në ditën që dikush atakohet me një dhimbje brenda familjes së vet rasti i parë t'i kërkohet se a ke kryer anëtarësinë, dhe në një formë po na qet ndër hije komplet këtë taksën qytetare.

Për fund unë nuk jam ai që kontraktoj me Bashkësinë Islame, mirëpo ta kenë parasysh që ata që hyjnë në marrëdhënie kontraktuale me Bashkësinë Islame sepse krejt këtë po e bëjmë për lehtësim të dhimbjes dhe shpenzimeve të atij që ka rast, dhe në atë ditë ti kërkohet në një formë edhe dhunshëm se ta ka zënë ditën më duket që është duke na zbehur gatishmërinë e Kuvendit Komunal që me marr pjesë në lehtësim e tij, pra qëllimi ishte krejt njerëzor në kuptimin që qëllimin që e kemi për lehtësimin e kësaj pune le ti shkojmë deri në fund.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, ju e keni materialin dhe e keni parë kërkesën se për çka kanë kërkuar Bashkësia Islame që të kompensohen, ata nuk kanë dashtë që të hyjnë në atë marrëveshje për hapjen e varrit, pra Bashkësia Islame nuk ka pranuar dhe ata i kanë dy arsyeje sepse unë kam biseduar me ta, njëra arsyeje ishte që për të hapë varr me ekskavator nuk mundesh sepse duhet të shkelesh mbi varret tjera dhe ka pengesa, ndërsa në Prishtinë i kam parë sepse aty shkojnë me rend dhe i hapin varret me ekskavator të vogël dhe nuk ka problem dhe kështu Bashkësia Islame në kërkesën që na ka bërë neve nuk e ka përfshirë shpenzimet e hapjes së varrit dhe nuk mundemi ne tani t'ia japi një obligim kur ajo nuk e ka kërkuar sepse edhe unë pajtohem me propozimin tënd (i drejtohet z.Naim Çunakut) sepse është lehtësim i madh dhe mendoj që është problemi më i madh se këto të tjerat, por në ditët e sodit numri i njerëzve që janë të pa punë dhe njerëzve që janë të lirë është shumë i vogël dhe është problem t'i gjejmë 3-4 persona që të hapim një varr. Pra edhe unë plotësisht jam me juve në këtë drejtim mirëpo para se t'ia japim këtë obligim është mirë që dikush nga ana jonë të takoj Kryetarin e Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë në mënyrë që të tregojnë se a janë të gatshëm ta marrin këtë barrë dhe me sa mjete mund të mbulohet ai shpenzim.

E them këtë sepse mendoj se ne nuk mund t'ia japim atyre këtë barrë kur ata vet nuk e kanë kërkuar, pra si Kuvend nuk mund ta bëjmë, kjo është brenga ime për arsye se ne edhe mundemi t'ia vëmë një shumë atyre kurse ata pastaj përgjigjen që nuk është reale dhe e arsyeshme ajo shumë, dhe në fund nuk e marrin këtë obligim, përndryshe në listën që është në material mund t'i shohim gjërat që ata i kanë kërkuar.

z.Naim Çunaku, theksoi, e gjitha kjo është në kuptimin e bisedimit dhe me qëllimin që të arrijmë një diçka që po mendojmë që ish dashtë të ishte. Zotëri Kryesues ti vazhdimisht po më thua se ata e kanë kërkuar këtë, por ata nuk diktojnë kushte sepse vendimmarrja është e jona dhe është shumë normale që Bashkësia Islame t'i kërkoj ato benifitet e veta, por edhe e tani se a jemi duke e lehtësuar komplet një njeri që e ka pasur rastin.

Po ashtu i nderuar Kryesues e përmende dhe po e theksoj edhe unë që të gjithë ne kemi pas raste dhe sot me të vërtetë është bërë telashe për ata familjar që e kanë rastin se hapja e varrit është puna më e rëndë, dhe kur më herët e përmenda Ndërmarrjen "Eko Llapi" unë nuk caktova se cilin model ta zgjedhim por duhet t'i kemi më shumë modele dhe nëse hyjmë në këtë do të ishte mirë që ai që negocion ta bëjë sepse ata i kanë bërë kërkesë Kryetarit të Komunës dhe Kryetari ka pas mundësi që të hyj në negociime me Bashkësinë Islame. Kryesuesi më herët e përmendi se Bashkësia Islame e ka të vështirë sepse nuk mund të hyjë ekskavatori, mirëpo sikurse unë edhe të tjerët kur e kemi rastin në familje dhe e bëjmë hapjen e varrit do të jenë të njëjtat kushte, pra a po nënkupton kjo se çka është lehtë po e marr dhe çka është vështirë po ia lëmë atij i cili e ka rastin, a po e bëjmë këtë për të lehtësuar apo po e bëjmë këtë për ta ndihmuar Bashkësinë Islame. Bashkësia Islame për atë që e ka rastin në familje dhe pikërisht në ditën e parë në një formë po tenton të marr dhunshëm anëtarësinë, pra sa i përket pjesës së vetë ajo absolut nuk lëshon pe, pra do të ishte mirë qoftë Kryetari i Komunës apo kushdo tjetër që negocion këtë, ajo duhet të negociohet si marrëveshje complete për lehtësimin komplet shpenzimit të varrimit dhe kur thua se i marr shpenzimet e varrimit edhe hapja e varrit është shpenzim i varrimit, ndërsa sa i përket Ndërmarrjes "Eko Llapi" meqë është Ndërmarrje komunale jo ne ta kontraktojmë atë por ta kontraktoj Bashkësia Islame, dhe nëse Bashkësia Islame nuk dëshiron që të lidhë atë kontratë e që edhe pjesën rituale e ka obligim, atëherë edhe ne si Kuvend t'ia paguajmë edhe njëherë pjesën rituale atyre.

z.Haki Rudari, theksoi, natyrisht se e nderuara kolege paraprkasht në emër të Grupit e dha përkrahjen për marrëveshjen e mirëkuptimit për kompensimin e shpenzimeve të varrimit, por unë do të ndalem tek një çështje e shpenzimit ku shuma e kësaj është 250 euro, natyrisht te ky propozim e kemi si arsyetim rritjet e çmimeve dhe ideja e kolegut tim në parim është njerëzore, humane dhe zyrtare sepse jemi anëtarë të Kuvendit të Komunës dhe është e vërtetë që kemi mungesë të faktorit njeri, mirëpo tani formën dhe modalitetin e kryerjes apo hapjes së varrit, ndoshta mbetet të debatohet edhe nesër në mbledhjen e Kuvendit, andaj po e theksoj sërish që propozimi është njerëzor dhe human për arsyeje mbi të gjitha se neve çka na përket të gjithëve është vdekja, mandej duhet të krijojmë kushte sa më të mira.

Pra edhe një herë po e theksoj që është ide shumë e qëlluar që së paku të debatojmë se a kemi mundësi, sepse siç u theksua më herët “Eko-Llapi” është Ndërmarrje komunale por se a mund të merr ajo përsipër kjo mbetet të shihet dhe do ta diskutojmë edhe nesër në mbledhjen e Kuvendit Komunal.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedhim në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe kërkesën e paraqitur nga anëtari i Kuvendit Komunal dhe këtij komiteti z.Naim Çunaku që të shqyrtohet mundësia për t’u përfshirë edhe hapja e varrit në kuadër të Listës së shërbimeve të varrimit që do të kryhen nga Këshilli i Bashkësisë Islame në Podujevë, për shqyrtim në Kuvend.

Njëzëri me 8 vota Për, nga anëtarët e pranishëm, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të këtij propozim vendimi sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe kërkesën e paraqitur nga anëtari i Kuvendit të Komunës dhe këtij Komiteti z.Naim Çunaku që të shqyrtohet mundësia për t’u përfshirë edhe hapja e varrit në kuadër të Listës së shërbimeve të varrimit që do të kryhen nga Këshilli i Bashkësisë Islame në Podujevës.

3. Draft Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës, për vitin 2025

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, e paraqiti fjalën hyrëse rreth draft Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2025, theksoi, siç e dimë të gjithë anëtarët e Kuvendit komunal kanë qenë të pajtimit që të marrin pjesë në hartimin e Planit të punës së kuvendit për vitin 2025 ku shumica e anëtarëve të Kuvendit kanë qenë pjesëmarrës dhe është bërë një draft Plan ku e kanë përkrahë të gjithë dhe besoj që edhe sot do të përkrahjet, nëse ndokush dëshiron të shton ndonjë gjë, qoftë nga Kuvendi qoftë nga Ekzekutivi, urdhëroni, nëse jo e hedh në votim që tçi rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Njëzëri me 7 vota Për, nga anëtarët/et sa ishin të pranishëm në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim Draft Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2025, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

4. Propozim vendimi për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025

znj.Saranda Stublla, drejtoresh e DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, pra si pikë e rendit të ditës e kemi listën e veçantë të pronave të paluajtshme të komunës për dhënie në shfrytëzim për vitin 2025, këtu janë të përfshira disa prona të cilat edhe të vitit 2024 kanë qenë ku komisioni nuk e ka kryer punën e vet ose thënë ndryshe një numër i konsiderueshëm i komisioneve për të njoftuar me njoftim publik për dhënie shfrytëzim dhe ato i kemi përsëritur prapë në këtë vit, ndërsa si

material shtesë ne i kemi sjell në KPF, pas konsultimit me Kryetarin e Komunës ku edhe propozoi që të përfshihen lokalet në parcelën nr.536 në Zonën Kadastrale Podujevë, prandaj kërkoj nga ana e juaj që të mbështetni këtë pikë të rendit të ditës.

z.Naim Çunaku, theksoi, po besoj që nesër do të debatohet për këtë, por po provoj shkurt, ku unë u ndjeva i shqetësuar me atë që e tha drejtoresha parafolëse që komisioni nuk e ka kryer punën e vet, nuk kam asnjë dyshim që është ashtu por vërtet është shqetësuese kur një trup i Kuvendit e voton një vendim dhe ka kaluar në fazë tjetër të ekzekutimit për miratimin e Kuvendit gjegjësisht ka abstenuar dhe ri rezultat i mos punës së komisioneve do të doja të dija se sa prona nuk kanë pasur mundësi të procedohen për shpallje publike, si dhe çështja tjetër është sa i përket lokaleve si pjesë e kësaj Liste e që është dashtë sot ta kemi materialin në mënyrë që ta dimë se ku janë ato lokale. Kur kemi biseduar për pronat komunale, me Ligjin për vetëqeverisjes lokale një prej detyrave parësore të Kryetarit të Komunës është ruajtja e vlerës së pronës komunale dhe në një formë mbajtja e saj në funksion të zhvillimit ekonomik, dhe duhet të llogaritim se sa prona komunale i kemi të pa shfrytëzuara ose shfrytëzohen në mënyrë të paautorizuar dhe për një moment sa të hyra vetanake do t'i krijonte Komuna nga ato prona të vjetra dhe sa do të kishin impakt në zhvillimin ekonomik po të ishin në funksion. Pra jeni duke e lënë një kapital të fjetur dhe marrim shembull objektin që është në fshatin Orllan, ai është shkatërruar nga mos funksionimi i tij dhe Komuna jon asnjë euro nuk ka pas mundësi të merr dhe ka investuar te ai objekt dhe në një kohë Komuna jon ka ndarë buxhet për të paguar rojtarin e ati objekti, në vend që ajo të ishte ndihmesë për buxhetin dhe në funksion të zhvillimit me këtë çështje besoj që është dashtë që të merremi pak më seriozisht dhe krejt kjo është në kuptimin e zhvillimit të mirëqenies dhe ruajtjes së pronës komunale.

znj.Drita Pajazit, theksoi, ne Grup i LVV e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës dhe e rekomandojmë për shqyrtim në Kuvendin e Komunës.

z.Bashkim Sylja, theksoi, edhe unë pajtohem me një pjesë të fjalimit të z.Naim Çunaku, sepse është shqetësuese që ky Kuvend i ka dhënë detyrë atyre komisioneve të cilat nuk e kanë kryer punën e vet, kështu që pasi e përmendi drejtoresha parafolëse besoj që është e rrugës të na tregoj se cilat komisione janë dhe për cilat prona bëhet fjalë, ndërsa sa i përket pronës shtesë që është, kur të na vijë materiali e diskutojmë nesër në Kuvend.

znj.Adelina Stublla, drejtoresh e DSHMS, theksoi, sa i përket punës së objektit në Orllan jam në komision dhe komisioni i ka shqyrtuar të gjitha çështjet deri te aplikimi, ku ka paraqitur kërkesën një Shoqatë Sportive dhe sot do të mblidhemi në mënyrë që të hapim ofertën dhe do shohim se çka do të bëhet.

znj.Saranda Stublla, drejtoresh e DPKGJ, theksoi, z.Naim Çunaku pyeti për numrin e saktë të komisioneve që nuk e kanë kryer punën e vetë dhe unë tani për momentin nuk e kam saktë numrin e komisioneve pasi që tash jam kthyer nga pushimi i lehonisë dhe vetëm më është dhënë informata se nuk e kanë kryer punën e tyre. Jeni në dijeni që përbërjet e komisioneve janë edhe nga anëtarët e opozitës edhe të pozitës, pra e jona si Drejtori është që të sjellim materialin dhe ta sjellim në Kuvend, ndërsa komisioni është i formuar nga Kuvendi dhe është i pavarur në punën e tij, andaj sa e di unë atyre i'u ka dërguar e-mail ushtruesi i detyrës së drejtorit të DPKGJ që ti ndërmarrin veprimet, por që nuk kanë marrë ato dhe pas konsultimeve edhe me Ministrinë më kanë propozuar që sërish t'i përsëritin këto prona, pra t'i përfshijmë në Listën e veçantë.

z.Naim Çunaku, theksoi, po filloj me drejtoreshën znj.Saranda Stublla, nuk e pata mendimin që të gjej fajtorin por vërtetë po nisem nga ajo që komisioni formohet nga Kuvendi dhe është nga të gjitha Grupet politike dhe nuk pata qëllime politike dhe qëllime që t'ia di emrin atij por vërtetë është shqetësuese në rend të parë ne si Kuvend sa jemi serioz kur një komision që e themelojmë vet ne dhe e votojmë dhe për fajin e tij mbetet një kapital i fjetur kjo pra është shqetësuese dhe nuk pata diçka tjetër, mirëpo është

dashtë që këtij Kuvendi t'i raportohet për mos punën e anëtarëve të Kuvendit në këtë rast sepse në një formë është bërë me fajin ton sepse votojmë diçka dhe nuk e zbatojnë.

Sa i përket çështjes së theksuar nga drejtoresha e DSHMS znj. Adelina Stublla, më vie mirë që më në fund asaj prone po i hapen rrugë dhe besoj shumë dhe do të doja shumë që të është në funksion të zhvillimit ekonomik, ndoshta të kujtohet në të kaluarën kur kemi qenë së bashku në KPF, ju keni propozuar për një destinim të asaj dhe unë e kam mbështetur, sepse prona komunale është e të gjithëve.

znj. Arnisa Sylejmani theksoi, meqë po flasim për punën e komisioneve në fjalë, unë kam qenë pjesë e dy komisioneve ku në njërin komision kemi qenë së bashku me drejtoreshën znj. Adelina Stublla, duke pasur parasysh se sa shumë pika të rendit të ditës për dhënie në shfrytëzim të pronave i kemi heq sepse nuk ka pasur interesim nga Shoqëria Civile dhe në momentin kur ka interesim dhe nuk kryhet puna nga ana e komisionit mendoj që nuk është një gjë e mirë, dhe nëse është e mundur që nesër në Kuvend të jepet një raport se përafërsisht kush nuk po e kryen punën dhe për cilat pronat po bëhet fjalë si dhe të kërkohet nga ana e komisionit arsyeja se pse nuk është vazhduar tutje në këtë proces.

znj. Drita Pajazit, theksoi, unë dua të pyes drejtoreshën e DPKGJ se mos e ka informatën gabim sepse e ceku edhe znj. Arnisa Sylejmani se janë votua një numër i madh i komisioneve me aq sa e di unë jam pjesë e tri komisioneve, vetëm një komision është thirrur ndërsa dy të tjera jo nuk ka pasur mbledhje, tash unë nuk e di se barra a i takon pjesës së Ekzekutivit apo neve si Komisione.

znj. Saranda Stublla, drejtoresh e DPKGJ, theksoi, sa kam informata unë për këtë vit Lista e veçantë komplet është ardhur në Kuvend për miratim, pra çdo parcelë është paraqitur në Kuvend dhe nëse është votuar nga Kuvendi dhe ka shkuar në Ministrinë përkatëse për shqyrtim të ligjshmërisë dhe që janë kthyer të gjitha vendimet, pra sa kam informata unë është kjo, por mund ta kem edhe gabim sepse nuk kam qenë në rrjedha dhe mundem të gaboj por kam informata nga shefja e pronës çdo parcelë që është e përfshirë në Listë të veçantë për vitin 2024 është proceduar në Kuvend për miratim, kurse nëse ka ndonjë një komision që nuk është formuar atë nuk e di, por nëse është formuar komisioni nga ky Kuvend dhe ka shkuar në Ministri për shqyrtim të ligjshmërisë ai komision është i ligjshëm dhe është dashtë që ta kryej punën.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, ne kemi formuar komisione për ato prona që kanë ardhur këtu në Kuvend dhe nuk kemi formuar komision për të gjithë Listën, por për ato prona që kanë ardhur kemi formuar komision dhe kemi pasur dy ose tri raste kur ka munguar Shoqëria Civile dhe i kemi heq disa prona por problemi është te ato prona që është formuar komisioni dhe nuk është punuar, për ato që nuk është formuar komisioni ne nuk kemi përgjegjësi.

znj. Drita Pajazit, theksoi, nuk është duke e kontestuar askush që është formuar komisioni, unë shqetësimin tim e pata që nuk jam thirr në mbledhje dhe tash pse nuk është thirr mbledhja dhe unë si anëtare e Kuvendit deri sa nuk pranoj ndonjë e-mail që është thirr mbledhja unë nuk mund të vij.

znj. Lirie Hoti, drejtoresh e DBPZHR, theksoi, ne duhet të shprehim interesim përderisa jemi të gjithë anëtarë i komisioneve përkatëse.

z. Haki Rudari, theksoi, komisionet që janë formuar në Kuvend të Komunës dhe nëse nuk gaboj përbërja është me 5 anëtarë ku 2 prej tyre janë nga Kuvendi, 2 nga Ekzekutivi dhe 1 nga Shoqëria Civile.

Komisioni ku unë kam qenë më duket se udhëheqës kanë qenë nga Ekzekutivi me dëshirë se ka mundësi me qenë më lehtë për të thirr, prandaj çdo komision e ka një udhëheqës dhe ai është i obliguar që të thirr mbledhjen, nëse udhëheqësi i komisionit është nga Ekzekutivi, pra duhet të bëjë ai, nëse udhëheqës është nga Kuvendi pra një anëtar i Kuvendit të Komunës, shembull konkret nëse unë jam udhëheqës i një komisioni dhe nuk e thërras është faji i imi, pra barra i takon kryesuesit të komisionit dhe çdo komision e ka një kryesues dhe aj kryesues që ka thirr anëtarët e atij komisioni nuk besoj që këta nuk kanë shkuar por nëse anëtarët e Kuvendit nuk janë shkuar është përgjegjësi e tyre.

Besoj që drejtoresha e ka pasur një pushim dhe nuk besoj që anëtarët e Kuvendit janë thirr e nuk kanë shkuar, të paktën nga Grupi jon LVV askush nuk na ka informuar që ka pasur thirrje dhe nuk kanë shkuar, pra përgjegjësia bie tek kryesuesi i komisionit kush do qoftë që është kryesues.

znj.Saranda Stublla, drejtoresh e DPKGJ, theksoi, vetëm një plotësim tek fjalimi i z.Haki Rudari, kur formohet komisioni në Kuvendin e Komunës nuk zgjidhet kryesuesi por thirret mbledhja nga ana e komisionit dhe duhet të jetë çdo anëtar i komisionit i interesuar që të veprojnë dhe mund të jetë kryesues edhe anëtar i Kuvendit të Komunës.

znj.Adelinë Stublla, drejtoresh e DSHMS, theksoi, ju sqaroi se kryesuesi i komisionit dhe procesmbajtësi caktohet gjatë takimit apo mbledhjes.

z.Naim Çunaku, theksoi, mendoj se duke diskutuar i japim edhe drejtim kësaj çështje, qëllimi është ky që Drejtoria e Pronës dhe Kadastrit dhe Gjeodezisë e ka obligim Ligjor që të gjitha pronat që dalin në shpallje publike për dhënie në shfrytëzim paraprakisht duhet të miratohen nga Kuvendi i Komunës dhe ne sot kemi Listën e atyre pronave për dhënie në shfrytëzim, ndërsa pjesa tjetër që e diskutuam se sa prej atyre pronave gjegjësisht si e thash në fillim sa prej kapitalit të Komunës që ka pasur mundësi me qenë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe krijimit të hyrave vetanake për Komunën dhe nuk i kemi në shfrytëzim për fajin e kujt që vërtetë kërkon trajtim të veçantë në Kuvend, sepse po ta marrim që 24 vite se sa prona kemi dhe sa të hyra kemi, ku janë ato prona dhe kush i shfrytëzon ato me çfarë kontrate i shfrytëzon, pra pa dashtë të të fajësoj ty drejtoresh e DPKGJ sepse janë bërë 24 vite dhe pjesa më e madhe e pronave komunale nuk kanë dal në funksionin siç e thotë Ligji për vetëqeverisje lokale në funksion të zhvillimit ekonomik dhe krijimit të vendeve të reja të punës, dhe kjo do të ishte shqetësuese për neve në funksion të mandatit që kemi, kurse ajo që më bëri përshtypje anëtarët e komisionit që votohen këtu dhe nuk e kanë kryer punën, mirëpo unë mendoj që në një të ardhme të afërt një pikë e veçantë e rendit të ditës kish qenë dashtë të kishte në fokus pronat komunale dhe shfrytëzimi i tyre.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje dhe konstatimeve të KPF-së.

Njëzëri me 8 vota Për, nga anëtarët/et sa ishin të pranishëm në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të propozim vendimit sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe propozimin për plotësimin e Listës në fjalë me pronën e paluajtshme, dhe atë:

Paluajtshmëria e evidentuar në Certifikatën pronësore me nr.prot.08-942/06-0078372/24 të datës 09.12.2024 - Lokalet afariste të ndërtuara në pjesën kadastrale P-536-0 në Zonën Kadastrale Podujevë, konkretisht në Njësinë ku është i ndërtuar Stadiumi i Qytetit të Podujevës "Zahir Pajaziti", si në vijim:

- Lokali nr.1 me sipërfaqe 60 m²
- Lokali nr.2 me sipërfaqe 60 m²
- Lokali nr.3 me sipërfaqe 60 m²
- Lokali nr.4 me sipërfaqe 60 m²
- Lokali nr.5 me sipërfaqe 60 m²
- Lokali nr.6 me sipërfaqe 60 m²
- Lokali nr.7 me sipërfaqe 60 m²
- Lokali nr.8 me sipërfaqe 60 m²
- Lokali nr.9 me sipërfaqe 60 m²
- Lokali nr.10 me sipërfaqe 60 m²
- Lokali nr.11 me sipërfaqe 120 m²
- Lokali nr.12 me sipërfaqe 120 m²

5. Informatë e Punës së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, korrik - nëntor 2024

znj.Adelinë Stublla, drejtoresh e DSHMS, e paraqit fjalën hyrëse rreth kësaj Informate, theksoi, kjo pikë të rendit të ditës është sipas Planit të punës së Kuvendit dhe propozoj për rekomandim në Kuvend.

znj.Sebastina Vokrri, theksoi, ne Grupi i LVV e përkrahim informatën e punës së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim.

z.Naim Çunaku, theksoi, duke e pasur parasysh që ky raport i punës është në vargun e përmbajtjes së Planit të punës së Kuvendit edhe ne Grupi i LDK e përkrahim, si një gjë vërtetë është përkujdes që të raportoj në bazë të asaj që e kemi në Plan të punës dhe unë dëshiroj që nesër të kemi një debat lidhur me gjendjen e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe njëkohësisht e falënderoj drejtoreshën për gatishmërinë sepse shumë prej tyre nuk e kanë shfaqur këtë gatishmëri edhe ka qenë me plan të punës së Kuvendit.

z.Bashkim Sylja, theksoi, edhe unë e përgëzoj drejtoreshën e DSHMS për informatën që e ka sjell, sepse është bërë praktike e keqe dhe ka Drejtori që nuk sjell raport qe 2 vite kurse DSHMS sjell raporte për 4 muaj dhe sjellë raporte për punën e vet.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, edhe unë e përgëzoj drejtoreshën e DSHMS që brenda vitit i ka dy raporte, kështu që po e kryen obligimin që e ka ndaj Kuvendit dhe e vë në votim që të rekomandohet për Kuvend.

Njëzëri me 7 vota Për, nga anëtarët/et sa ishin të pranishëm në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

6. Informatë e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

znj.Lirie Hoti, drejtoresh e DBPZHR, e paraqit fjalën hyrëse rreth kësaj Informate, theksoi, sipas Planit të punës së Kuvendit për vitin 2024 kësaj radhe e kemi informatën e dytë për këtë vit për Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ku sipas pikës së rendit të ditës nesër do të bëjmë raportimin lidhur me projektet e përfunduara për vitin 2024 në këtë Drejtori.

z.Naim Çunaku, theksoi, e përkrahim informatën e DBPZHR, dhe vërtetë është një përkushtim për raportim në bazë të Planit të punës dhe për këtë mund t'ju përgëzoj për korrektësinë që keni dhe e përmbani, ndërsa kontributin për të gjeturat apo përmbajtjen e procesit do të bëjmë nesër në Kuvend.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedhim në votim që të rekomandohet për mbledhjen e Kuvendit.

Njëzëri me 7 vota Për nga anëtarët/et sa ishin të pranishëm në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesues i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:05

Procesverbalin e mbajti;

Enis Sheholli

Nr.Prot.01-060/04-0078473/24

Podujevë,

10 dhjetor 2024

Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit

Hilmi Hoxha